



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 46, Datë 17.02.2026

MBI

**RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “DEVOLL HYDROPOWER” SH.A. NË
VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “ç” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “d”, 5, pika 1, gërma “d”, 13 dhe 16 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 17.02.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 134/3 prot., datë 13.02.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë “DEVOLL HYDROPOWER” sh.a. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “DEVOLL HYDROPOWER” sh.a. është licencuar në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar, me vendimin e bordit të ERE-s nr. 81, datë 09.06.2016, dhe i është rinovuar licenca me vendimin e bordit të ERE-s nr. 134, datë 07.06.2021, me afat vlefshmërie deri më 10.06.2026.
- Ajo ka paraqitur kërkesën për rinovimin e kësaj licence, me shkresën e protokolluar në ERE, me nr. 2825/1 prot., datë 10.12.2025, brenda afatit të përcaktuar nga rregullorja.
- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 335, datë 18.12.2025, vendosi të fillojë procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 20.12.2025 dhe 22.12.2025) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 29.12.2025), nuk rezultoi të ketë të tilla. Gjithashtu njoftimi për fillimin e procedurës u botua në rrjetet sociale dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.
- ERE, me shkresën nr. 2825/4 prot., datë 24.12.2025, ka njoftuar shoqërinë për fillimin e procedurës, si dhe i ka bërë me dije informacionin/dokumentacionin që nevojitet të plotësohet për këtë aplikim.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 20 prot., datë 06.01.2026, shoqëria ka depozituar informacion/dokumentacion plotësues, nga shqyrtimi i të cilit rezultoi se kishte ende dokumentacion që nevojitej të plotësohej, në lidhje me vërtetimin e shlyerjes së detyrimeve ndaj organeve tatimore, mbështetjen financiare dhe planin e biznesit, ndaj bordi i ERE-s me vendimin nr. 07, datë 15.01.2026, vendosi të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes për aplikimin e shoqërisë për rinovimin e licencës së furnizimit të energjisë elektrike.
- ERE, me shkresën nr. 134/2 prot., datë 22.01.2026, i është drejtuar shoqërisë duke i kërkuar depozitimin e dokumentacionit të munguar.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 20/1 prot., datë 10.02.2026, shoqëria ka depozituar informacionin/dokumentacionin e munguar të aplikimit.
- Nga shqyrtimi i aplikimit, rezulton se shoqëria disponon aktualisht zyrat përfaqësuese të furnizuesit, por duke qenë se afati i kontratës së qirasë përfundon më 31 mars 2026 dhe nuk mbulon afatin 5-vjeçar të licencës, vlerësohet t'i lihet kusht shoqërisë që brenda kësaj date të depozitojë në ERE kontratën e rinovuar për përdorimin e zyrave përfaqësuese të furnizuesit ose një dokument me disponimin e tyre për periudhën e mbetur të licencës.
- Për sa dokumentuar nga shoqëria, shlyerja e detyrimeve tatimore është pjesë e një shqyrtimi gjyqësor që ndodhet në proces, ndaj vlerësohet që shoqërisë t'i lihet kusht për depozitimin e vendimit të gjykatës në lidhje me këtë çështje, sapo ta disponojë atë.
- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit, ka shlyer të gjitha pagesat e rregullimit, si dhe ka plotësuar dokumentacionin tjetër në zbatim të *“Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”*, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të rinovojë licencën nr. 343, Seria F16/F21, të shoqërisë “DEVOLL HYDROPOWER” sh.a., për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr.81, datë 09.06.2016, dhe rinovuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 134, datë 07.06.2021, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 11.06.2026.
2. Brenda datës 31.03.2026, shoqëria duhet të depozitojë në ERE kontratën e rinovuar të qirasë për përdorimin e zyrave përfaqësuese të furnizuesit ose një dokument në lidhje me disponimin e tyre për periudhën e mbetur të licencës.

3. Shoqëria duhet të depozitojë në ERE vendimin e gjykatës në lidhje me detyrimet tatimore menjëherë sapo ta disponojë atë.
4. Ky vendim është objekt rishikimi në varësi të plotësimit/mosplotësimit të kushteve të vendosura në pikat 2 dhe 3.
5. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë shoqërinë “DEVOLL HYDROPOWER” sh.a., OST sh.a., OSSH sh.a. dhe ALPEX sh.a., për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI